



HYRESE - ULAZNA - INCOMING

MINISTRIA E ADMINISTRATES SË PUSHTETIT LOKALE
MINISTARSTVO LOKALNE SAMOUPRAVE I ADMINISTRACIJE
MINISTRY OF LOCAL GOVERNMENT ADMINISTRATION

Nr: 773/05

Data: 07.12.2005

KOSOVË - KOSOVO



INSTITUCIONET E PËRKOZHSHME TË VETËQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT

MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL
MINISTARSTVO ADMINISTRACIJE LOKALNE SAMOUPRAVE
MINISTRY OF LOCAL GOVERNMENT ADMINISTRATION

UDHËZIM ADMINISTRATIV I MAPL Nr. 2005/8

PËR PËRCAKTIMIN E KOMPETENCAVE DHE PËRSHKRIMIN E DETYRAVE TË ZYRTARET/ËT PËR BARAZI GJINORE NË KOMUNA.

Duke u bazuar në Nenin 9.3,1. të Rregullorës së UNMIK-ut, Nr. 2001/9 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, Nenit 1.3 (ç) të Rregullores së UNMIK-ut, Nr. 2001/19, të datës 13 shtator 2001, mbi Degen e Ekzekutivit të Institucioneve Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, Rregullores së UNMIK-ut, Nr. 2005/15, mbi ndryshimin e Rregullores mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes, Rregullorës së UNMIK-ut, Nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut, Nr. 2004/18, të datës 7 qershor 2004, mbi shpalljen e Ligjit për Barazi Gjinore në Kosove, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, konform nenit 4.15, i këtij ligji, MAPL nxjerr Udhëzimin Administrativ nr.2005/09, për Përcaktimin e kompetencave dhe përshkrimin e detyrave për zyrtaret/ët për Barazi Gjinore në Komuna.

Neni 1 Qëllimi

- 1.1 Ky udhëzim administrativ ka për qëllim caktimin e kompetencave dhe përshkrimin e detyrave për zyrtaret/ët për Barazi Gjinore në Komuna.
- 1.2 Zyrtaret/ët për Barazi Gjinore në komuna kontribuon në promovimin, avansimin, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, me theks të vecant respektimin e barazise gjinore.

Neni 2

- 2.1 Në pajtim me Ligjin për Barazi Gjinore Nr.2004/2, neni 4.15 të gjitha komunat e Kosovës zgjedhin "Zyrtarin/Zyrtaren për Barazi Gjinore në Komunë.

2.2 Në të gjitha komunat e Kosovës, bazuar në Ligjin për Barazi Gjinore Nr.2004/2, do të jetë emërtimi i unifikuar “Zyrtari/ja për Barazi Gjinore”.

2.3 Mbrenda 30 ditësh, pas nënshkrimit të këtij Udhëzimi Administrativ nga Ministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, të gjitha komunat janë të obliguara të bëjnë unifikimin e këtij emërtimi.

Neni 3 Struktura

- 3.1 Zyrtari/Zyrtarja për barazi gjinore në komuna i përgjigjet drejtpërsëdrejti Kryeshefit Ekzekutiv.
- 3.2 Zyrtari/Zyrtarja për Barazi Gjinore në komunë bashkepunon me Zyren për Barazi Gjinore të Kosovës.
- 3.3 Zyrtaret/ët për Barazi Gjinore në Komuna kontribuojnë në zbatimin e Ligjit për Barazinë Gjinore dhe koordinojnë aktivitetet te ndryshme me ZBGJ e Kosoves ne sferen e arritjes se barazise gjinore, perfshire ngritjen e kapaciteteve si dhe bashkrendimin e aktiviteteteve tjera te paparapa në takimet te rregullta mujore, të organizuara nga ZBGJ.

Neni 4

Detyrat dhe Përgjegjësitë e Zyrtarit/es për Barazi Gjinore në Komuna

Nën mbikqyrjen e përgjithshme të Kryeshefit Ekzekutiv të komunës Zyrtari-ja do të:

- Koordinojë dhe mbikqyrë të gjitha aktivitetet në promovojne barazine gjinore ne komunë;
- Kontribuon ne formulimin e planeve dhe të politikave mbrenda komunës qe nderlidhen me barazine gjinore
- Merr pjesë ne panelin per rekrutimit te shërbyesve civil në komunë, për të siguruar respektimin e të drejtës gjinore;
- Mban statistikë-baze te shenimeve, dhe i analizon ato nga prespektiva gjinore
- Inicojë programe dhe projekte për të përmirsuar përfaqësimin gjinor në shërbimin civil në komunë, duke përfshi avansimin e pozitës së gruas në struktura të larta të shërbimit civil;
- Merr pjesë në hartimin e akteve të nxjerrura nga komuna, duke siguruar që aktet të jenë në pajtim me parimet themelore të të drejtave te njeriut respektivisht te grave;
- Bashkëpunojë me të gjitha strukturat e nivelit lokal për të promovuar, avansuar dhe mbrojtur të drejtate grave;
- Ndihton dhe përkrahë trajnimet e organizuara që kanë për qëllim ngritjen e vetëdijes për avansimin e barazise gjinore në komunë;
- Këshillojë dhe udhëzojë organet e komunës lidhur me çështjet gjinore dhe respektimin e të drejtave te grave;

- Përfaqësojë komunën në takimet e ndërlidhura për çështjet gjinore;
- Bashkëpunon me zyrtaren-in për barazi gjinore të MAPL-së dhe me Zyren për Barazi Gjinore të Kosovës;
- Merr pjesë në koordinimin e OJQ-ve lokale dhe ndërkombëtare dhe punon drejt zhvillimit dhe avansimit të çështjeve gjinore;
- Përgaditë raporte javore mujore dhe vjetore mbi çështjet gjinore në komunë;
- Sipas nevoje kryen edhe punë tjera që janë të ndërlidhura me çështjet gjinore, e që janë në kompetencë të komunës.

Neni 5

Përgjegjësinë për zbatimin e këtij udhëzimi e kanë Kryshefat Ekzekutiv të Komunave


Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi pas nënshkrimit, të Ministrit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Prishtinë, më 5.12.2005

Lutfi Haziri, Ministër i Ministrisë
së Administrimit të Pushtetit Lokal


05/11/2005